



## Memorandum Bashkëpunimi

I lidhur në Gjakovë me datë 13.01.2020, në mes të palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues: Komuna.
2. Organizata Joqeveritare Anibar, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Vullnet Sanaja, në tekstin vijues "Anibar".

### 1. Përshkrimi i organizatës

**Organizata Joqeveritare Anibar:** Anibar është një organizatë e themeluar në vitin 2010 nga një grup aktivistësh të rinj të artit. Misioni i organizatës Anibar është thyerja e apatisë qytetare përmes aktivizmit kulturor. Misioni i organizatës zhvillohet përmes tre programeve: edukimi qytetarë, zhvillimi i kulturës dhe produksioni i filmit. Tre programet janë implementuar në bashkëpunim me partner lokal dhe ndërkombëtarë.

### 2. Qëllimi i bashkëpunimit

Ky Memorandum i Bashkëpunimit paraqet një marrëveshje të nënshkruar në mes të organizatës joqeveritare Anibar dhe Komunës së Gjakovës që do të mundësoj hapësirën për zhvillimin e programit të praktikës në komunën përkatëse nga studentët dhe zhvillimin e platformës online për qasjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal. Përmes këtij dokumenti do të mundësohet realizimi i suksesshëm i komponentëve të projektit "Të Rinjtë për Ndryshim" nga Anibar në kuadër të programit Angazhimi për Barazi - E4E i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID Kosovo dhe zbatuar nga Advocacy Training and Resource Center - ATRC.

### 3. Përgjegjësitë e Palëve

Në frymën bashkëpunues, për të arritur qëllimet e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, organizata Anibar dhe komuna e Gjakovës, pajtohen të përmbushin përgjegjësitë si më poshtë:

#### Për organizatën joqeveritare Anibar:

- a. Anibar bazuar në projekt propozim, do të përkujdeset që të bëjë shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e 2 studentëve në komunën përkatëse të cilët do të përfitojnë nga programi i praktikës 3-mujore me pagesë.
- b. Anibar bazuar në projekt propozim, do të përkujdeset për vendosjen e praktikantëve të përzgjedhur në departamentin përkatës të komunës dhe të bëjë monitormin e punës së praktikantëve në baza mujore.
- c. Anibar bazur në projekt propozim, do të përkujdeset për pagesën mujore me kohëzgjatje 3-mujore për 12 praktikantë, respektivisht, 2 praktikantë për secilën nga 6 komunat e Rrafshit të Dukagjinit (Pejë, Klinë, Istog, Deçan, Junik dhe Gjakovë).
- d. Anibar do të zhvillojë përmbajtjen e platformës online duke krijuar kështu një hapësirë në të cilën të rinjtë do të kenë mundësinë të paraqesin kërkesat/projekt propozimet në komunën përkatëse me qëllim të përmirësimit të jetës në komunitet. Platforma do t'i lejojë qytetarët të ndajnë nevojat e tyre përmes ideve të projektit të tyre dhe t'i shikojnë ato duke u zbatuar ndërsa promovojnë pjesëmarrjen aktive qytetare.

#### Për Komunën e Gjakovës:

- a. Komuna e Gjakovës do të mundësojë mbajtjen e programit të praktikës me pagesë 2 studentëve të përzgjedhur në periudhë kohore 3-mujore, kështu duke i akomoduar në drejtoritë/departamentet përkatëse të komunës.
- b. Komuna e Gjakovës do të mundësojë kryerjen e plotë të programit të praktikës me kohëzgjatje 3-mujore për dy praktikantë të përzgjedhur nga organizata Anibar. Po ashtu do të përkujdeset që praktikantët të akomodojnë në hapësira ku do të rrisin kapacitetet profesionale të tyre.
- c. Komuna e Gjakovës do të mundësojë që organizata Anibar të inkuadrojë platformën online (link) në faqen zyrtare në internet të komunës së Gjakovës dhe të parasheh mirëmbajtjen e saj. Komuna e Gjakovës do të mundësojë që kërkesat/projekt propozimet e paraqitura në platformën online të merren parasysh në takimet e Kuvendit Komunal me qëllim të realizimit të tyre nëse ato janë të bazuara dhe të realizueshme. Po ashtu, pajtohet që kërkesat/projekt propozimet e dorëzuara të marrin përgjigje brenda afatit kohor për realizimin ose mos realizimin e tyre.
- d. Komuna e Gjakovës pajtohet që kërkesat/projekt propozimet e paraqitura do të pranohen, rishikohen dhe të analizohen nëse do të mund të implementohen bazuar në analizën e fizibiliteti, arsyetueshmërisë dhe buxhetit që posedon.

*Të dyja palët pajtohen që çdo produkt/material i prodhuar nga ky bashkëpunim në kuadër të projektit "Të Rinjtë për Ndryshim" do të përdoren logot përkatëse nga organizata Anibar.*

#### 4. Kohëzgjatja e Memorandumit

Ndryshimet dhe modifikimet mund të bëhen vetëm pas kërkesës me shkrim nga cilado palë dhe mund të hyjnë në fuqi pas marrëveshjes nga të gjitha palët.

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet në mënyrë të menjëhershme nga cilado palë me pëlqim të përbashkët, ose gjashtë muaj pas njoftimit me shkrim dërguar palëve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe zgjat deri në përfundimin e përgjegjëseve të parapara nga palët në kohën e implementimit të projektit.

#### 5. Kopjet e Memorandumit

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është krijuar në gjuhën shqipe në dy kopje për secilën palë nënshkruese të këtij dokumenti.

**Vullnet Sanaja**

Drejtor Ekzekutiv, Anibar



**Ardian Gjini**

Kryetar, Komuna e Gjakovës

